



Pranuar / Doretuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	09.12.2021	1	viti god year
Organ /Rjesja Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	5936/2021		119



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.924/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Arditë Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.47/2020 të datës 10.11.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me datë 12.11.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër protokollit 5668/2019 të datës 04.12.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi Rruga: "Nën Tereza" pa nr., Komuna e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim më datën 09.12.2021, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.748/2019 dhe me numër të protokollit 5668/2019 e datës 04.12.2019 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi njoftimi i datës 11.07.2019 për përzgjedhjen e kandidatit/es për pozitën "Zyrtar i lartë i burimeve njerëzore (Personelit).

### A r s y e t i m

Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil, me datë 08.07.2019 ka aprovuar kërkesën e Komunës së Prishtinës, për autorizimin e shpalljes së konkursit për pozitën: "Zyrtar i Lartë i Personelit" në Komunën e Prishtinës.

Pas marrjes së miratimit nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil, Komuna e Prishtinës me datë 11.07.2019, ka publikuar konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës "Zyrtar i Lartë i Personelit".

Ankuesja ka aplikuar në konkursin e shpallur të datës 11.07.2019 nga Komuna e Prishtinës, për vendin e punës "Zyrtar i Lartë i Personelit" në Komunën e Prishtinës. Pas njoftimit zyrtar të datës 12.09.2019, për përzgjedhjen përfundimtare të kandidates nga

Komuna e Prishtinës, ankuesja e pa kënaqur me njoftimin e datës 12.09.2019 për kandidatin e suksesshëm, me datë 10.10.2019 ka parashtruar ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Prishtinës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Prishtinës, nuk ka vendosur për ankesën e ankueses së datës 10.10.2019 dhe ankuesja kundër heshtjes së organit të punësimit me datë 04.12.2019 parashtron ankesën me numër të protokollit 5668/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim ankimor kundër përzgjedhjes së kandidatës për pozitën "Zyrtar i lartë i burimeve njerëzore (Personelit), si dhe shkeljeve të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 09.12.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Prishtinës. Me datë 17.12.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 13.12.2019 me numër të protokollit 5819/2019 e ka njoftuar ankuesen për pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e saj të datës 04.12.2019 dhe se e ka udhëzuar ankuesen që ti ndjek më tutje procedurat ligjore. Ankuesja ka parashtruar padi me datë 24.11.2020 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative kundër heshtjes së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datë 10.11.2021 merr Aktgjykimin me numër A.nr.47/2020 me të cilin aktgjykim aprovohet kërkesëpadia e paditëses  
Anulohet akti administrativ (njoftimi) i datës 13.12.2019 dhe e detyron Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të marrë vendim të vendos lidhur me ankesën e paditëses së datës 04.12.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër A.nr.47/2020 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimi i datës 13.12.2019 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e ankueses e datës 04.12.2019 me numër protokollit 5668/2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e ankueses e datës 10.10.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Komunën e Prishtinës; Autorizimi i konkursit nga MAP/DASHC i datës 08.07.2019; Konkursi i datës 11.07.2019; Aplikacionet e kandidatëve Form.MAP-SHCK-04; Lista e ngushtë e kandidatëve e datës 20.08.2019; Njoftimi për përzgjedhje përfundimtare e datës 12.09.2019; Kërkesa për punësim e datës 25.07.2019 e kandidatës me dokumentacionin individual i bashkangjitur; Testi me shkrim për kandidaten Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a për kandidaten Kërkesa për punësim e datës 24.07.2019 e kandidatës me dokumentacionin e bashkangjitur; Testi me shkrim për kandidaten Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj Form.MAP-SHCK-08a e



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën e lartcekur është zhvilluar në pajtim me nenin 7, paragrafi 7, nenin 16 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4 dhe nenin 11 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”* dhe dispozitave të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.


Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Lënda: A.nr.924/2021, datë 09.12.2021

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-gjyqtarja Lirije Maksutaj
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën Prishtinë;
- Arkivit të KPMSHCK-së.